VENDIM
Nr. 46, datë 30.3.2016

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE SHTESË NGA BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA

Në bazë të nenit 12, shkronja "a", nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", dhe nenit 54, pika 2, shkronja "dh", nënpika "v" të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, i ndryshuar; me propozim të Departa-mentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

- ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve; si dhe
- tregtimin për llogari të saj, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të bëjë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko